

Seancë publike e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve

Rendi i Ditës:

Projektvendim “Për plotësimin e vakancës në Këshillin e Bashkisë Tiranë.”


Pjesëmarrja:

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Stafi i KQZ: Ylli Merkaj, Erjon Meta

Z.I.Celibashi: Mirë atëherë fillojmë seancën publike, për shqyrtim nga ana e Komisionerit shtetëror të zgjedhjeve të çështjeve. Në rendin e ditës si vijon, për plotësimin e vakancës në Këshillin e Bashkisë Tiranë. Pika tjetër e rendit të ditës ka të bëjë me plotësimin e vakancës në Këshillin e Bashkisë Mat dhe pika e tretë e rendit të ditës ka të bëjë me plotësimin e vakancës në Këshillin e Bashkisë Skraparë. Atëher meqënëse nuk është paraqitur asnjë prej palëve të interesuara po dhe përfaqësues të Partive Politike, fillojmë me relatimin, sekretari i KQZ-së.

Z.Y.Merkaj: Nga ana e Këshillit të Bashkisë Tiranë datë 24.11.2020 ka njoftuar KQZ-ve për krijimin e vakancës për Këshilltarin Z.Toni Janaq Gogu propozuar nga subjekti politik Partia Socialiste. Në zgjedhjet Kombëtare të Qeverisjes Vendore të vitit 2019 Partia Socialiste e Shqipërisë në Këshillin e Bashkisë Tiranë ka fituar 56 mandate, nga të cilat 28 meshkuj dhe 28 femra. Në këto kushte referuar nenit 164 të Kodit Zgjedhorë, kandidati vijues nga lista shumemërore e Partisë Socialiste të cilit i kanë dhënë mandat është kandidati me numër rendor 61 Znj.Orsa Ylli Ulqinaku të cilët KQZ-ja i kishte drejtuar një kërkesë për plotësim dokumentacioni. Në përgjigje të kërkesës së KQZ-së kandidati për anëtar të Këshillit Bashkiak ka plotësuar dhe depozituar formularin e vetëdeklarimit me numër unik 0061 nga ku rezulton se nuk ka deklaruar asnjë të dhënë e cila ka të bëjë me ndalimet në parashikim të ligjit me nr.138 të vitit 2015. KQZ-ve ka kërkuar informacion nga zyra e Gjëndjes civile dhe zyra e Gjëndjes Gjyqësore, ku



*Mbledhje e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
të datës 5.01.2021, ora 13:00*

Drejtoria e Përgjithshme e Gjëndjes Gjyqësore në datën 29.12.2020 kadërguar verifikimin e Gjëndjes Gjyqësore për kandidaten Znj.Orsa Ylli Ulqinaku nga ku rezulton se është e pa dënuar nga Gjykatat Shqipëtare. Drejtoria e Përgjithshme e Gjëndjes Civile ende nuk ka kthyer përgjigjë në kto kushte konstatohen se të dhënat e kandidatit për Këshillin e Bashkisë Tiranë Znj.Olsa Ylli Ulqinaku nuk përbëjnë kushte për mos zgjedhshmëri në funksionin e kandidatit të anëtarit të Këshillit të Bashkisë Tiranë, prandaj dhe Këshilli i Bashkisë do të vazhdojë procedurat për dhënien e mandatit të kësaj kandidateje, faleminderit.

Z.I.Celibashi: Po, faleminderit mirë atëherë meqënëse lidhur me këtë pikë nuk kemi gjë tjetër bazuar në atë çfarë ju relatuat dhe në dokumentacionin e paraqitur si dhe bazuar në nenin 19 paragrafi 1 shkronja n dhe paragrafi 2 në nenin 164 të Kodit Zgjedhorë të ndryshuar si dhe nenin 11 të ligjit 138 2015 për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen emërohen ose ushtrojnë funksione publike, si dhe kreun 5 të Vendimit të Kuvendit nr.17 datë 2016 për përcaktimim e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimit e parashikuar në ligjin nr.138 2015 për garantinë e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose strojnë funksione publike.

Vendos:

1. Zonja Orsa Ylli Ulqinaku kandidat për anëtar në Këshilli e Bashkisë Tiranë nuk përfshihet në kushtet e mos zgjedhjes për ushtrimin e funksionit.
2. Plotësimin e vakancës në Këshillin e Bashkisë Tiranë me kandidatin nga lista shumëmemërore të Partisë Socialiste të Shqipërisë Znj.Orsa Ylli Ulqinaku.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim, në Komisionn e Ankimeve dhe Sanksioneve brenda 3(tre) ditëve nga hyrja në fuqi e këtij vendimi. Ky vendim hy në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të KQZ-së.
dhe ky Projektakt.

Vendimi nr.1

*Zbardhi materialin e inçizuar
Albana Ndoci*



Seancë publike e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve

Rendi i Ditës:

Projektvendim “Për plotësimin e vakancës në Këshillin e Bashkisë Mat.”

Pjesëmarrja:

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Stafi i KQZ: Ylli Merkaj, Erjon Meta

Z.I.Celibashi: Vazhdojmë me pkën e dytë të rendit të ditës që ka të bëjë me plotësimin e vakancës në Këshillin e Bashkisë Mat, po fjala për ju.

Z.Y.Merkaj: Po, Këshilli i Bashkisë Mat në datë 20.07.2020 ka njoftuar KQZ-ve për krijimin e vakancës nga Këshilltari Z.Bledar Nazif Hysa propozuar nga subjekti politik Partia Demokracia Sociale. Në zgjedhjet për Organet e Qeverisjes Vendore të vitit 2019. Partia Demoracia Sociale në Këshillin e Bashkisë Mat ka fituar një mandat. Në këto kushte referuar nenit 164 të Kodit Zgjedhorë kandidati vijues nga lista shumemërore i partisë Demokracia Sociale për Këshillin e Bashkisë Mat, është kandidat me numër rendor 5 Z.Agim Sali Klosi, të cilit KQZ-ve i ka dërguar kërkesën për plotësim dokumentacioni. Në përgjigje të kërkesës KQZ-ve kandidati për anëtar në Këshiln e Bashkisë Mat ka plotësuar dhe depozituar formularin e vetëdeklarimit me nr. unik 60. nga ku vërtetohet se nuk ka deklaruar asnjë të dhënë cila ka të bëjë me ndalimet për parashiket e ligjit nr.138 të vitit 2015. KQZ-ve ka plotësuar dhe ka kërkuar informacion nga zyra e Gjendjes Gjyqsore dhe nga zyra e Gjendjes Civile. Nga Drejtoria e Përgjithshme e Gjëndjes Gjyqsore në datën 29.12.2020 është dërguar verifikimi i gjendjes Gjyqsore për kandidatin Z.Agim Sali Klosi rezulto i padënuar nga Gjykatat Shqipëtare. Drejtoria e Përgjithshme e Gjëndjes Civile ende nuk ka kthyer përgjigje. Në këto kushte konstatohet se të dhënat e kandidatit për anëtar të Këshilt të Bashkisë Mat Z.Agim

*Zbardhi materialin e inçizuar
Albana Ndoci*



*Mbledhje e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
të datës 5.01.2021, ora 13:00*

Sali Klosi nuk përbëjnë kusht për mos zgjedhjen e tij në funksion të kandidatit. Në këto kushte Këshilli i Bashkisë Mat mund të vazhdojë procedurat për dhënien e mandatit të këtij kandidati, faleminderit.

Z.I.Celibashi: Faleminderit, atëherë meqënëse dhe për këtë pikë të rendit të ditës nuk kemi tjetër për të shtuar bazuar në dokumentacionin e paraqitur si dhe bazuar në nenin 19 paragrafi 1 shkronja n dhe paragrafi 2 të Kodit Zgjedhorë të Republikës së Shqipërisë ndryshuar nenin 11 të ligjit 138 2015 për garantim të integritetit të personave që zgjidhen emërohen ose ushtrojnë funksione publike, kreun 5-të të Vendimit të Kuvendit nr.17 2016 për përcaktimim e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimet e parashikuar në ligjin nr.138 të vitit 2015 për garantinë e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike.

Vendos:

1. Z.Agim Sali Klosi kandidat për anëtar në Këshilli e Bashisë Mat nuk përfshihet në kushtet e mos zgjedhshmërisë për ushtrimin e funksionit të Këshilltarit.
2. Plotësimin e vakancës në Këshillin e Bashkisë Mat me kandidatin nga lista shumëemërore të Partisë Demokratice Z.Agim Sali Klosi.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim, në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve brenda 3(tre) ditëve nga hyrja në fuqi e këtij vendimi. Ky vendim hy në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të KQZ-së.

Vendimi nr.2

*Zbardhi materialin e inçizuar
Albana Ndoci*



Seancë publike e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve

Rendi i Ditës:

Projektvendim “Për plotësimin e vakancës në Këshillin e Bashkisë Skrapar.”

Pjesëmarrja:

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Stafi i KQZ: Ylli Merkaj, Erjon Meta

Z.I.Celibashi: Kalojmë te pika e tretë dhe e fundit e rendit të ditës që ka të bëjë me plotësimin e vakancës në Këshillin e Bashkisë Skrapar.

Z.Y.Merkaj: Këshilli i Bashkisë Skrapar në datë 16.11.2020 ka njoftuar KQZ-ve për krijimin e vakancës nga Këshilltari Z.Esat Ali Pashaj propozuar nga subjekti politik Partia Socialiste e Shqipërisë. Në zgjedhjet për Organet e Qeverisjes Vendore të vitit 2019. Partia Socialiste e Shqipërisë në Këshillin e Bashkisë Skrapar ka fituar 13-të mandate nga ku 7 janë meshkuj dhe 6 janë femra. Referuar nenit 164 të Kodit Zgjedhorë kandidati vijues të cili i takon vendi i mbetur vakant është kandidat me numër rendor 16 Znj.Minevere Enver Brahimasi , të cilit KQZ-ve i ka dërguar kërkesën për plotësim dokumentacioni. Në përgjigje të kërkesës KQZ-ve kandidatia për anëtare e Këshillit të Bashkisë Skrapar ka plotësuar dhe depozituar formularin e vetëdeklarimit nga ku rezulton se nuk ka deklaruar asnjë të dhënë që ka të bëjë me ndalimet për ligjin nr.138 të vitit 2015. KQZ-ve ka kërkuar informacion nga zyra e Gjendjes Civile dhe nga zyra e Gjendjes Gjyqësore. Nga ku drejtorja e Përgjithshme e Gjendjes Gjyqësore ka kthyer përgjigje pas verifikim të gjendjes Gjyqësore të Kandidtit ku rezulton i padënuar nga Gjykatat Shqipëtare. Drejtorja e Përgjithshme e Gjendjes Civile ende nuk ka kthyer përgjigje. Në këto kushte duke qenë se të dhënat e kandidatit nuk përbëjnë kusht për mos zgjedhjen e kandidatit në funksion të Këshilltarit



*Mbledhje e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
të datës 5.01.2021, ora 13:00*

konstatohet se i plotëson kushtet dhe duhet të vazhdojë procedurat për dhënien e mandatit të këtij kandidati, faleminderit.

Z.I.Celibashi: Faleminderit, atëherë bazuar në relatimin tuaj dhe në dokumentacionin mbi të cilin është bërë ky relati si dhe bazuar në nenin 19 paragrafi 1 shkronja n dhe paragrafi 2 në nenin 164 të Kodit Zgjedhorë të Shqipërisë së ndryshuar nenin 11 të ligjit 138 2015 për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen emërohen ose ushtrojnë funksione publike, si dhe bazuar në kreun 5-të të vendimit të Kuvendit të Shqipërisë me nr.17 të vitit 2016 për caktimim e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimet e parashikuar në ligjin nr.138 të vitit 2015 për garantinë e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike.

Vendos:

1. Znj.Minevere Enver Brahimasi kandidat për anëtar në Këshillin e Bashkisë Skrapar nuk përfshihet në kushtet e mos zgjedhshmërisë për ushtrimin e funksionit të Këshilltarit.
2. Plotësimin e vakancës në Këshillin e Bashkisë Skrapar me kandidatin nga lista shumëmemërore të Partisë Socialiste të Shqipërisë Znj.Minevere Enver Brahimasi.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim, në Komisionn e Ankimimeve dhe Sanksioneve brenda 3(tre) ditëve nga hyrja në fuqi e këtij vendimi. Ky vendim hy në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të KQZ-së.

Faleminderit, mbledhja mbyllet.

Vendimi nr.3

*Zbardhi materialin e inçizuar
Albana Ndoci*

